

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

JANAR 2016

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërën prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja.

Me fat!



* A 6 3 7 7 4 *

FAQE E ZBRAZËT

Duke shfrytëzuar tekstin përgjigju në pyetjet 1, 2, 3 dhe 4.

Për të gjitha sugjerimet, informacionet ose këshillat mund të kontaktoni



**QENDRA PËR MBROJTJEN E
KONSUMATORËVE**

Bulevar revolucije 9
81 000 Podgorica
Tel: +382 20 244 170
e-mail: cezap@t-com.me
www.cezap.org

Kjo broshurë është krijuar me ndihmën e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit "Ura e konsumit evropian". Broshura nuk përmban një komunikatë formale dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

This brochure has been produced with the assistance of the EU, within the EU-funded project „European Consumer Bridge“. This brochure does not constitute a formal communication and does not necessarily represent the official position of the European Union.



*Projekti "Ura e konsumit evropian"
Project "European Consumer Bridge"*



**ÇFARË DUHET TË DINI
PËR KREDITË**



Projekti i financuar nga Bashkimi Evropian
This project is funded by the European Union

1. Shkruaje titullin e projektit pjesë e të cilit është kjo broshurë.

1 pikë

2. Cili është qëllimi i projektit në fjalë?

1. Të informojë klientët potencial sesi të vijnë më lehtë te kredia e nevojshme
2. T'u tërheqin vërejtjen klientëve për dëmin që mund t'u ndodhë nëse nuk janë sa duhet të informuar
3. Të promovojë rëndësinë e Qendrës për Mbrojtjen e Konsumatorëve

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

3. Shkruaji saktë tri mënyra në të cilat konsumatorët mund të fitojnë informacione për të drejtat e veta nga Qendra për Mbrojtjen e Konsumatorëve CEZAP, pa shkuar në zyrat e atij institucioni.

1 pikë

4. Broshura nuk përmban komunikatë formale dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht qëndrimin zyrtar të Bashkimit Evropian.

Përcaktoje llojin e fjalëve nga fjalia e dhënë:

formale _____

domosdoshmërisht _____

nuk _____

1 pikë

Lexoje tekstin 1 dhe 2 pastaj zhvilloji detyrat 5, 6 dhe 7.

1. Në QKI “MALËSIA” në Tuz, më 13.05.2016, në orën 20, do të shfaqet premiera e komedisë “BURRI BURRË”. Autor i kësaj komedie është Kristo Floqi, kurse ajo vjen në skenë nga Teatri i Qytetit të Vushtrrisë. Rolet kryesore i luajnë Besart Bunjaku, Blerta Gubetini, Bujar Haxhaj dhe Dredhëza Shala. Regjisor i shfaqjes është Fazli Muharremi-Tali, kurse skenograf Bahri Muzaqi. Kjo shfaqje do të jepet pas një jave edhe në Ulqin, ndërsa në Plavë është planifikuar më 1 qershor.
2. Humori i komedisë në fjalë është shumë gazmor. Ai trajton problemet të përditshmërisë tonë, me theks të veçantë lakminë e cila është po aq e vjetër sa edhe vetë njerëzimi. Aktorët e shfaqjes shkëlqejnë dhe mishërohen plotësisht me rolet e tyre, ndërsa skenografia i jep një impuls të veçantë komedisë që nga fillimi deri në fund të saj.

5. Cili është qëllimi i tekstit të dytë?

1. Të informojë për mbajtjen e shfaqjes
2. Të tregojë shkurt përmbajtjen e shfaqjes
3. Të njoftojë për vendet e shfaqjes së saj

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

6. Pranë konstatimit i cili është i saktë rretho S, kurse nëse është i pasaktë rretho P dhe shpjegoje përgjigjen tënde.

KONSTATIMI	Saktë Pasaktë	SHPJEGIMI I PËRGJIGJES
Tema është e njëjtë në të dy tekstet	S P	
Tekstet i takojnë të njëjtit lloj.	S P	
Për vënien në skenë të kësaj shfaqjeje meritat i takojnë QIK “Malësia” në Tuz	S P	

3 pikë

7. Duke u bazuar nga pamja e shfaqjes, çfarë mund të konstatosh, në cilën kohë është vendosur ngjarja e shfaqjes?



1. Të kaluarën
2. Të tashmen
3. Të ardhmen

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin përgjigju në pyetjet 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

RESTORANTET MË TË PAZAKONSHME NË BOTË

Kuzhinat kombëtare nuk janë më sfidë e restoranteve të kohës sonë ultramoderne. Në kërkimin e ndonjë gjëje të ndryshme, diçka që nuk është parë dhe origjinale, karakteristike kryesore u bënë meny-të e pazakonshme, por edhe konceptet e pazakonshme të gatimit.

„El Buli” është më se një restorant, ai është një oazë e vërtetë e kuzhinës që 6 muaj ekziston në mes të shkretëtirës së përditshmërisë. 6 muajt e tjerë mbyllet në mënyrë që t’ju mungojë, që ta dëshironi vendin, të zakonshëm vetëm në shikim, kafene vetëm në shikim. „El Buli” është një Mekë e vërtetë gastronomike e haxhilerëve grykës e të gjitha meridianëve. Në të nuk ka ndonjë ushqim që shquhet në mënyrë të veçantë, sepse çdo gjë që shërbehet është kryevepër. Sipas jurisë së revistës prestigjioze Restorant, „El Buli” tre vjet me radhë është restoranti më i mirë në botë. Gjetet në qytezën Roses në bregun e Kosta Bravës në Spanjë dhe punon nga prilli gjer në shtator, kurse rezervimet bëhen një vit më parë. Gjatë një sezoni gjithsej ka 8000 vende, për të cilat paraqiten rreth gjysmë milion njerëz. Çdo natë, 50

gjellëbërës gatujnë më së shumti për 50 mysafirë. Gjellëbërësi kryesor – Feran Adria Akosta (1962) pas përfundimit të sezonit, tërhiqet në atelienë e vet të kuzhinës / laboratorin në Barcelonë ku prej fillimi e përpilon meny-në e plotë për vitin e ardhshëm. Darkat në këtë restorant zgjasin nga disa orë dhe përmbajnë tridhjetë ushqime. Racionet janë mjaft të vogla, por çdo racion është rrëfim më vete. Që përjetimi të jetë i plotë, duhet të ndiqen me kujdes rekomandimet e gjellëbërësve. Shërbehen kokteje në formë të kubit të borës, të fletëve të holla, në dukje si të letrës, të stërpikur me lule me ngjyra të forta dhe në fakt edhe ‘vezë’ çili, në të cilat në vend të kuqit të vesë ndodhet kremi me shije të karameles....

Cilësia e ushqimeve që ofrohen në „El Buli” është e jashtëzakonshme. Pronarët thonë se gatimi është një gjuhë me të cilën kreativiteti, harmonia, gëzimi, bukuria, poezia, magjia, humori dhe kultura shprehen më së miri. Të gjitha këto i ka çdo pjatë e vetme në „El Buli”.

(Përgatitur sipas tekstit të Klubit 360, 2008)

8. Ky tekst është pjesë e:

1. lajmit
2. komentit
3. reportazhit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

9. Me cilin stil funksional është shkruar teksti?

1 pikë

10. Në cilin vend ndodhet restoranti “El Buli”?

1 pikë

11. Në ç’ mënyrë shërbehen koktejet në këtë restorant?

1 pikë

12. Për sa mysafirë gatujnë darkën çdo mbrëmje 50 gjellëbërës?

1. Për pesëdhjetë mysafirë
2. Për tetë mijë mysafirë
3. Për një gjysmë milioni mysafirë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

13. Mysafiri mund të darkojë në këtë restorant nëse e rezervon vendin:

1. një vit përpara
2. prej prillit deri në shtator
3. tre vjet radhazi
4. gjatë sezonit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

14. Sipas mendimit të pronarëve të restorantit, gatimi i ushqimit është gjuha më e mirë e të shprehurit. Shpjegoje pohimin e tyre duke u bazuar në tekst.

1 pikë

15. Në cilën kohë është folja shkruanim?

1 pikë

16. Me çfarë marrëdhënieje bashkërenditëse është periudha: *Korrupsioni gjendet kudo, kurse talenti është gjë e rrallë*? Jepe shpjegimin.

1 pikë

17. Në fjalinë: *Me një fjalë, tokë e qiell po nënqeshnin të gëzuar, mbiemri është:*

1 pikë

18. Mbi vija përballë fjalive të poshtëshënuara shkruaji rasat e emrit të nënvizuar.

1. Profesorin e pashë para oborrit të shkollës. _____
2. Detyra e profesorit është e vështirë. _____
3. Profesori im është i sjellshëm. _____
4. Profesorit i dhanë një dhuratë. _____

1 pikë

19. A) Fjalën nga kllapat përdore në rasën e duhur.

Ariani shpeshherë prej (pullaz) _____ e shikonte ndeshjen e futbollit.

1 pikë

B) Cila rasë është kjo?

1 pikë

20. A) Brodha anë e kënd qytetit, por nuk e takova dot.

Në fjalën e nënvizuar kemi ndryshimin fonetik të njohur si:

1. Aferezë
2. Apofoni
3. Metafoni
4. Sinkopë

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

B) Shpjegoje përgjigjen tënde.

1 pikë

Lexoji vargjet dhe përgjigju në pyetjet 21, 22, 23, 24, 25 dhe 26.

Paqe, jo, nuk gjej, e luftë s' kam me njeri,
Kam frikë e shpresë, digjem e akulloj,
Në qiell fluturoj, por prapë në tokë rri,
S' përqafoj kënd e botën në krahë pushtoj.

Rob i saj jam, s' më kyç as jep liri,
S' më do për vete e lakut s' i dredhoj,

S' më vret e prangat më lë kjo dashuri,
Të gjallë s' më do e s' mundem t'i shpëtoj.

Shiko pa sy, gjuhë nuk kam e bërtas,
E dua të vdes, e prapë kërkoj ndihmë;
Veten urrej, ndërsa të huajin dua.

Dhimbja më ushqen e vaji më del me gaz;
As jeta as vdekja s' më pëlqejnë një grimë,
Në këtë gjendje jam nga ti, o grua!

21. Si quhet forma poetike në të cilën është shkruar poezia?

1 pikë

22. Rrethoje numrin para motivit të poezisë, pastaj zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. Erotik
2. Social
3. Patriotik

1 pikë

23. Gjeje një simbol nga vargjet e dhëna dhe trego domethënien e tij kontekstuale.

1 pikë

24. Përshkrimi në vargun: *Të gjallë s' më do e s' mundem t'i shpëtoj, poetit i shërben për të ndierë:*

1. dhembshuri për motrën e tij
2. hir për vuajtjet e vëllait të tij
3. mëshirë për vuajtjet e veta

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

25. A) Në këtë poezi hasim edhe paradoksin. Çfarë paraqet në kuptimin figurativ vargu ku është përdorur paradoksi?

1 pikë

B) Përshkruaje vargun ku do ta dëshmosh përgjigjen tënde.

1 pikë

26. A) Cilën figurë stilistike ka përdorur poeti në vargun:

Paqe, jo, nuk gjej, e luftë s' kam me njeri,

1. Antitezën
2. Krahasimin
3. Metaforën

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

B) Shpjegoje përdorimin e figurës stilistike në këtë varg.

1 pikë

Duke shfrytëzuar tekstin përgjigju në pyetjet 27, 28 dhe 29.

Hamleti:

Ah, mos kujto se po ta them për lajkë;
Se çfarë avantë mund të pres prej tejet,
Që tjetër pasuri s' më ke në botë,
Veç mendjes m' prehtë për jetesën tënde.

(Uilliam Shekspir "Hamleti")

27. Cilit lloj letrar i përket pjesa e veçuar?

1. Dramës
2. Epikës
3. Lirikës

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

28. Cilën temë trajton vepra nga e cila është veçuar kjo pjesë?

1 pikë

29. Nga vargjet e dhëna marrim vesh se Hamleti mendon veç për:

1. lajkatarët
2. të zgjuarit
3. veten e tij

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve 1 pikë

30.

Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rretho numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë. Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kij kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. MIHAL GRAMENO "OXHAKU"

Udhëzime për shkrimin e esesë:

Shkruaj për:

- Për periudhën letrare që i takon Mihal Grameno.
- Formën letrare ku bën pjesë "Oxhaku".
- Simbolikën e emërimit të veprës.
- Ngjarjen që zhvillohet në vepër.
- Rrethanat që bënë që ngjarja të merrte një kahe negative.
- Intrigat që bëhen në vepër.
- Shkaktarin kryesor të të gjitha vështirësive dhe komplikimeve në vepër.
- Ndryshimin në jetën e personazheve në vepër.
- Njohjen e Vahidesë me Rushan beun.
- Gërshetimin e ngjarjeve që sjellin deri tek fundi i lumtur.
- Porosinë që jep vepra "Oxhaku".

2. ZANATI (NUK)ËSHTË ME VLERË ARI

Udhëzime për shkrimin e esesë:

- Numëroji llojet e ndryshme të punëve dhe zanateve.
- Sqaroje sa është me rëndësi të zgjidhet puna që e duam.
- Përshkruaje një zanat që mendon se kërkon njohuri, aftësi, por edhe kreativitet.
- A do të kishe dëshirë që të ushtrosh ndonjë zanat. Argumentoje përgjigjen tënde.
- Jepe qëndrimin tënd në raport me temën.
- Jepi të paktën dy argumente që mbështesin mendimin tënd.
- Provoje me argumente mendimin tënd me së paku një shembull për argumentin tënd .

25 pikë

